



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2342 Prot.
3

Durrës, më 26.11.2024

V E N D I M

Nr. 38, Datë 26.11.2024

PËR

**"RIORGANIZIM NËN MASËN 20% TË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE NË "MENAXHIM BIZNES", PRANË
DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT, NË FAKULTETIN E BIZNESIT, TË
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; në Udhëzimin e MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, si dhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë me Nr. 2302/3 prot., datë 25.11.2024, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e riorganizimit nën masën 20% të programit të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Menaxhim Biznes", pranë Departamentit të Menaxhimit, në Fakultetin e Biznesit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët,
 - Drejtuesi i Njësisë Kryesore,
 - Drejtuesi i Njësisë Bazë,
 - Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2025-2026.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

